



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 24, datë 12.06.2026



**PËR MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS “ARTUR BUJARI” ME  
VENDNDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE RRASHBULL, BASHKIA DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” i ndryshuar, Ligjit nr.114/2015 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 475, datë 23.12.2017 “Për miratimin e sistemit të ri të adresave të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,


**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI:**

1. Miratimin e emërtimit të rrugës “Artur Bujari” me vendndodhje: Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, sipas planvendosjes bashkëngjitur.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Urban dhe Zhvillimit të Territorit dhe Ndërmarrja Rruga, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR**

**Denisa Luarasi**



**U shpall sot me datë 15.06.2026**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS


Nr. 417 prot.  
3

Durrës, më 18.06.2026

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.24 datë 12.06.2026 “Për miratimin e emërimit të rrugës “Artur Bujari” me vendndodhje: Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
ADRIAN GURRA**

